



Abdullah (Jashar) QORRAJ ka lindur më 01.07.1953 në fshatin Ticë KK. Skenderaj. Shkollën fillore katër klasëshe e ka mbaruar në Ticë, ndërsa kl.VIII në Likoc. Gjimnazin në Skenderaj. Fakultetin Filologjik-Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë.

Në vitin shkollor 1976 ka filluar të punoi si arsimtar në shkollën fillore “ Emin Duraku “, tani “ Fehmi Rama “ në Likoc, paralelja e ndarë fizike në fshatin Aqarevë. Në vitin 1986 fillon të punoi si arsimtar në ish QAMO “ Ramiz Sadiku “ , më vonë “ Anton Çetta” në Skenderaj. Nga shtatori i vitit 1996 është kthyer të punoi në fshatin e tij të lindjes në Ticë si arsimtar i Gjuhës shqipe me orë plotësuese nga lëndë tjera. Si arsimtar ka udhëhequr grupin letrar me emrin “ Fan S. Noli”, grupin e recitatorëve, grupin dramatik, grupin e piktorëve të vegjël etj.

Nga 1 shkurti i vitit shkollor 2007 emrohet drejtor i shkollës fillore “ 2 Korriku “ në Ticë. Po nga shkurti i vitit 2010, rizgjidhet prap drejtor i kësaj shkolle me mandat katër vjeçar. Për punën e tij si drejtor, DKA-ja më 7 mars 2010 e shpall si drejtorin më të suksesshëm në vitin shkollor 2009/10 në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe e nderon me mirënjohje.

Në vitin shkollorë 2012/13, DKA-ja prap e shpallë drejtorin më të suksesshëm në SHFMU dhe e shpërblen me një telefon celular. Është i afërt me nxënës, puntorët e shkollës dhe komunitetin. Në dokumentacionin e tij janë 13 çertifikata të ndryshme duke filluar nga programi psiko-social, MNQ, QPEA, KEDP, PLZSH, PPSH, Udhëheqësi arsimorë 2 çertifikata etj.

Gjatë luftës së lavdishme të UÇK-së gjatë viteve 1998/99 ka shërbyer në Shtabin Emergjent - Logjistika Ushtarake e UÇK-së në Likoc duke qenë në shërbim të UÇK-së ditën dhe natën. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet Lokale dhe Parlamentare dhe ka dhënë një kontribut të madh. Ka organizuar shumë aksione në nivel shkolle apo fshati, sidomos vlenë të përmendet Projekti i rrugës Likoc – Ticë dhe më vonë edhe asfaltimi i kësaj rruge.

Është drejtori i cili më 16 maj 2014 ka vënë Gurthemelin e shkollës së re së bashku me Kryemnistin e

Republikës së Kosovës z.Hashim Thaqi dhe kryetrain e Komunës z.Fadil Nura.

Është drejtori i cili më 10 maj 2016 e hapë derën e shkollës së re e cila ishte ndertuar dy vite më parë.

Të gjithë: stafi mësimdhënës ,administrativ e teknik së bashku më nxënës gëzohen kur e fillojnë mësimin

në lokalitetin e ri një muaj para mbarimit të vitit shkollorë 2017/18

Është pensionuar më 01/07/2018.